



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:056883

Datë: 01.12.2021

Numri i dokumentit: 02456500

PPP.nr.99/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbaremore të kreditorit “E...”, sh.p.k, me seli në Ferizaj, rr “...”, kundër debitorit “A...”, sh.p.k, me nui ..., me seli në Ferizaj, rr “...”, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 01.12.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “A...” sh.p.k, i ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbaremit P.nr.23/2021, të datës 27.01.2021, i lëshuar nga përmbareuesi privat Mubarak S.Shumolli nga Ferizaj dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr.23/2021, i datës 27.01.2021.

A r s y e t i m

Me urdhrin mbi lejimin e përmbaremit P.nr.23/21, të datës 27.01.2021, përmbareuesi privat Mubarak S.Shumolli e ka caktuar përmbareimin e propozuar nga kreditori “E.” sh.p.k, kundër debitorit “A...” sh.p.k, me seli në Ferizaj, për detyrimin e debitorit, për pagesën e borxhit në shumë prej 3,092.28 euro dhe shpenzimet e procedurës së përmbaremit, në bazë të faturave nr.751-210-001-19, e datës 20.11.2019 dhe 862-210-001-19, e datës 30.12.2019, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të kreditorit ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të palujtëshme të debitorit.

Kundër urdhrit mbi lejimin e përmbaremit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që të pranohet prapësimi si i bazuar.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhëri për përmbarim.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin mbi lejimin e përmbarimit dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata me rastin e rishikimit të procedurës së përmbarimit në bazë të nenit 43, par 4, të LPP-së, vlerësoj se urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.23/2021, i datës 27.01.2021, i lëshuar nga përmbaruesi privat Mubarak S.Shumolli, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njejt nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, ngase përmbaruesi privat në këtë rast e ka lejuar përmbarimin në bazë të nenit 29, par 1, nën par 1.3, të LPP-së, në të cilin është përcaktuar shprehimisht se fatura konsiderohet dokument i besueshëm në bazë të cilës mundë të caktohet përmbarimi.

Sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se: përmbaruesi privat gabimisht ka vendosur kur ka lejuar përmbarimin për faktin se debitori asnjëherë nuk e ka pasur për qëllim që t'i shmanget realizimit të pagesave të cilat i ka pasur ndaj kreditorit, mirëpo debitori dhe kreditori kanë pasur një marrëveshje paraprake që në rast se materialet elektrike të cilat debitori i ka marrë nga kreditori nuk janë në rregull dhe nuk punojn të kthehen prap te kreditori, Gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara sepse pretendimet e tilla por edhe pretendimet tjera në prapësim të debitorit nuk bëjnë pjesë në grupin e shkaqeve të prapësimit të parapara në dispozitat e nenit 71, par 1, të LPP-së po ashtu pretendimet e tilla mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm në procedurën kontestimore por që në procedurën përmbarimore gjykata nuk ka të drejtë dhe kompetencë të hetoj fakte por vetëm të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së nxjerrjes së urdhërit për përmbarim. Përndryshe faturat të cilat janë përmendur më lart që të gjitha janë të nënshkruara nga kreditori dhe debitori dhe të dorëzuara në origjinal të tyre dhe kësaj të njejtat i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme nga neni 29, par 1, nën par 1.3, të LPP-së. Vlen të theksohet se faturat e përmendura më lart janë në tërësi të përshtatshme për përmbarim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, sepse në fatura janë treguar të dhënat e kreditorit dhe debitorit, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Gjithashtu në fatura është shënuar edhe koha e arritjes së kërkesës së kreditorit për arkëtim që nënkupton se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 30 dhe nenit 36 par 1, të LPP-së.

Po ashtu propozimi për përmbarim i kreditorit në bazë të cilit është nxjerr urdhëri për përmbarim në rastin konkret siç konstatohet i njejt është përpiluar në pajtim të plot me nenin 38, par 1 dhe 2, të LPP-së, për shkak se propozimi e përmbanë kërkesën për përmbarim në të cilën janë treguar të gjitha faturat si dokumente të besueshme, po ashtu i përmban të dhënat e plota të kreditorit dhe debitorit duke e përfshirë adresën e selisë së kreditorit e posaçërisht të debitorit, numrin e regjistrimit të biznesit përkatësisht numrin unik identifikues të debitorit si dhe të gjitha të dhënat e tjera që konsiderohen të nevojshme për ta zbatuar përmbarimn në fjalë. Po ashtu debitori siç konstatohet nga faturat e propozuara nga kreditori me propozim për përmbarim, i njejt është i njoftuar në hollësi me përmbajtjen e tyre dhe shumën e borxhit për arsye se që të

gjitha faturat në bazë të cilave është nxjerr urdhëri për përmbarim janë të nënshkruara nga vetë debitori.

Andaj, gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, thëniet e kreditorit në përgjigjen në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.23/2021, i datës 27.01.2021, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe në bazë të nenit 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
PPP.nr.99/21, më datë 01.12.2021

GJYQTARI
Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykates së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.